



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0457-A0001

Në çështjen juridike të:

B B, i përfaqësuar nga avokat Sh Xh ,Gjilan.

Paditësi

Kundër:

NSH Industria e Duhanit, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr.

“Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.

E paditura/ankuesja

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2640, të datës 19 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-2640, i datës 19 korrik 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 11 prill 2014, paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJSK kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të NSH Industria e Duhanit, e adminstruar nga AKP (AL i AKP-së) GJI003-0583/0125 të datës 10 mars 2014. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 1.772.38 euro, për periudhën gusht 2003- maj 2004, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar konform

nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (LPB). Padiësi pretendon se pas luftës ka punuar në ish- NSH-në Industria e Duhanit në Gjilan, mirëpo të njëtit NSH-ja nuk i'a paguar të ardhurat personale prej muajit gusht të vitit 2003 e deri më 20 maj 2004. Sipas padiësit, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të gjithë punëtorët ishin njoftuar me shkresën e datës 15 gusht 2006, ishin njoftuar se, "shumat-pagat që u janë borxh sipas kontratës të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likudimit, si dhe do të kontaktohen kur të fillojnë këto procedura". Me këtë njoftim, sipas padiësit, ishte ndërprerë rrjedha e parashkrimit dhe ishte pranuar borxhi. Padiësi propozoi që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe t'i njihet e drejta në kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 1.772.38 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Më 26 janar 2017, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së padiësit, theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e padiësit, duke i konsideruar të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura ka pohuar se nuk ka prova që ankuesi ka dorëzuar kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër komtent brenda periudhës tre vjeqare të parashkrimit, pra tri vite nga gushti i vitit 2003.

Më 19 korrik 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykim C-IV.-14-2640 me të cilin ishte aprovuar si e bazuar ankesa e padiësit, ishte ndryshur Vendimi i AL të AKP-së.GJI003-0583/0125, i datës 10 mars 2014, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën gusht 2003- maj 2004, t'i paguaj padiësit shumën prej 1.772.38 euro, në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore, t'i paguajë shumën prej 177.23 euro, dhe në emër të shpenzimeve procedural shumën prej 124,00 euro. Këto shuma të aprovuara, do të përmbushen në pajtim të proriteteve sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likudimit. Në arsyetim të vendimit thuhet se me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1.772.38, gjykata është bazuar në listen për pagat e pa paguara, ashtu që për vitin 2003, përkatësisht për muajin gusht i është njohur paga në shumën prej 122.34 euro, për muajin shtator i është njohur paga në shumën prej 192.10 euro, për muajin tetor në shumën prej 192.21 euro, për muajin nëntor në shumën prej 192.57 euro dhe për muajin dhjetor në shumën prej 191.98 euro. Po ashtu në bazë të kësaj liste, padiësit i janë njohur pagat për vitin 2004, përkatësisht për muajin janar në shumën prej 194.35 euro, për muajin shkurt në shumën prej 193.28 euro, për muajin mars në shumën prej 171.98 euro, për muajin prill në shumën prej 192.10 euro dhe për muajin maj në

shumën prej 129,47 euro. Gjithësejtë ankuesit i janë njohur pagat e pa paguara në shumë prej 1.772.38 euro.

Pretendimi i të paditurës së kërkesa është parashkruar, nuk është i saktë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore, ngase paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL të AKP-së dhe parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 15 gusht 2006. Sipas Shkallës së parë vonesa e fillimit të procedurës së likudimit nuk mund t'i atribuohet paditëses dhe t'i momohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën lartëcekur është njoftuar se kërkesat kreditore mund t'i parashtrij kur të fillojë procedura e likudimit. Andaj duke u nisur nga kjo gjendje, Shkalla e parë kishte ardhur në përfundim se paditësi kishte ofruar shërbime pune për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh për pagat për periudhën e lartëcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e pa paguara.

Më 11 gusht 2022, e paditura/ankuesja kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi duke propozuar që të ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë në pajtim me nenin 9.10 të Ligjit 06/L-086, duke e refuzuar ankesën ndaj Vendimit GJI003-0583/0125, të datës 10 mars 2014 si të pa bazuar, si dhe duke e vërtetuar kët vendim të Autoritetit të Likudimit. Aankuesja pretendon se Shkalla e parë ka ngatërruar dy afate krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Afati i parë është afati për parashtrim të kërkesave, që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit, ky afat e kërkesën e parashtruesit e bënë të pranueshme dhe nuk ka të bëjë me meritat e kërkesës. Afati i dytë ka të bëjë me meritat e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatoj një kërkesë, andaj një kreditor i NSH-së duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet. Nëse një kreditor dështon të përmbush një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. E paditura e kundërshton konstatimin e Shkallës së parë lidhur me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, duke sqaruar se ky njoftim e informon punëtorin se ai ka të drejtë të parashtrij kërkesë pranë AKP-së, e jo që ai nuk ka më nevojë t'i mbroj të drejtat e tij me mjetet e tjera ligjore të cilat janë në dispozicion, dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen në process të likudimit. Në fakt, kërkesa e parashtruesit është shqyrtuar nga AL i AKP-së dhe në fund të procesit të shqyrtimit është konstatuar se ajo është e parashkruar. Më 19 tetor 2023,

Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së e ka dërguar tek paditësi këtë ankesë për përgjigje. Përfaqësuesi i paditësit e kishte pranuar urdhënin gjyqësor më 20 tetor 2023, por nuk ka dërguar asnjë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të ligjit nr.06/L086 mbi Dhomën e Posqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Shkalla e parë e DHPGJSK-së, me aktgjykimin e ankimuar e kishte aprovuar ankesën si të bazuar, e kishte ndryshuar Vendimin e kundërshtuar të AL të AKP-s, duke e obliguar të paditurën që në emër të pagave të papaguara për periudhën gusht 2003-maj 2004, paditësit t'i paguaj shumën prej 1.772.38 euro me interesin ligjor prej 10% të shumës themelore në shumën 177,23 euro dhe shpenzimet gjyqësore në shumën prej 124,00 euro, në procedurë të likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

AKP në kundërshtimin e këtij aktgjykimi thekson se konstatimi i Shkallës së parë se kërkesa nuk është parashkruar, është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të drejtën të parashtrij kërkesën pranë AKP-së. AKP e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të PB-së.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet këto pretendime të AKP-së pasi që ato nuk janë të mbështetura në prova konkrete dhe në argumente juridike. Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me konstatimin e Shkallës së parë të DHPGJSK-së se kërkesa për paga nuk është parashkruar, pasi që është e qartë se AKM paditësit ia kishte dërguar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 15 gusht 2006, i cili dokument e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit të kërkesës. Në këtë njoftim shprehimisht ceket se “Shumat – pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës tuaj te punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave te likuidimit dhe do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”. Duke u bazuar në këtë Njoftim, paditësi me arsye ka pritur fillimin e

procedurës së likuidimit të NSH-se më 04 korrik 2007, dhe pastaj pas njoftimit të shpallur nga AKP, në afatin ligjor e ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se AKP me mbrojtjen në ankesë të dorëzuar në DHPGJSK, e kundërshton kërkesën për paga vetëm për shkak të parashkrimit, ndërsa nuk ka ndonjë kundërshtim shprehimor lidhur me lartësinë e kërkuar të kompensimit. Andaj duke u bazuar në faktin që lartësia e kompensimit nuk është kundërshtuar nga AKP dhe duke u bazuar edhe në faktin se paditësi me ankesën e tij edhe para Shkallës së parë kishte dorëzuar si provë edhe Listat e pagave të punëtorëve të NSH-së, që kanë mbetur pa u paguar për periudhën gusht 2003 e deri në maj 2004, në të cilën listë paditësi është në numrin rendor 162, Kolegji i Apelit konstaton se Shkalla e parë e DHPGJSK-së me të drejtë e ka aprovuar kërkesën e paditësit për paga në shumë e larëcekur.

AKP në ankesën e saj, pa ndonjë bazë ligjore i kundërshton konstatimet e dhëna të Shkallës së parë, pasi që këto konstatime e kanë mbështetjen edhe të Kolegjit të Apelit. Është e qartë se paditësi ka ofruar prova të mjaftuara që dëshmojnë se ai kishte të drejtë në pagat e kërkuara ndaj NSH-së, për periudhën gusht 2003-maj 2004, në shumë e pretenduar. Kolegji i Apelit nuk e mbështet pretendimin e AKP-së se kërkesa për këto paga është parashkruar, pasi që, siç është deklaruar në shumë raste në jurisprudencën e DHPGJSK-së, Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, e ndërpret rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Në këtë rast paditësi e ka pranuar këtë njoftim nga AKM-ja me të cilën i është ndërprerë marrëdhënia e punës më 15 gusht 2006, andaj duke u bazuar në udhëzimet që i kishte në njoftim ai ka vendosur t'i pret procedurat e likuidimit të NSH-së dhe pastaj të paraqitet me kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit.

Pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave procedurale dhe për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, nuk janë mbështetur me prova dhe fakte konkrete dhe ato pretendime nuk pranohen si të bazuara nga ana e Kolegjit të Apelit.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

AKP për ankesën e saj tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 dhjetor 2023.

Mr. sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues _____